



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

RAPORT TEMATIK

MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Autor: **Megi Reçi**

SHQIPËRIA
KUVENDIM

PËRMBLEDHJE

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) zhvilloi ushtrimin e parë në rang kombëtar të anketimit deliberativ,¹ të quajtur “Shqipëria n’Kuvendim” dhe të mbajtur në Tiranë në datat 18-21 nëntor 2021. Anketimi deliberativ mbështetet në tre anketa – një anketim me kampion përfaqësues kombëtar prej 1,200 të anketuarish, një anketim me një grup eksperimental² me 110 të anketuar dhe një tjetër anketë me një grup kontrolli³ me 110 të anketuar të tjerë. Gjetjet e këtij raporti tematik mbështeten tek të dhënat e anketimit kombëtar⁴ si dhe në këndvështrimet e pjesëmarrësve të grupeve të vogla të diskutimit⁵ të organizuara gjatë aktivitetit “Shqipëria n’Kuvendim”. Anketimi kombëtar paraqet perceptimet dhe qëndrimet e shqiptarëve ndaj alternativave të mundshme për zgjidhje për një sërë çështjesh që lidhen me mbikëqyrjen parlamentare, pjesëmarrjen e qytetarëve në veprimtarinë parlamentare, demokracinë e brendshme të partive politike, sistemin zgjedhor, votën e diasporës, ndryshimet klimatike dhe imigrimin ekonomik në Shqipëri.

Nga anketimi kombëtar u konstatua një nivel i ulët i besimit të publikut ndaj institucionit të Kuvendit, ku 40% e të anketuarve raportuan se nuk i besonin aspak këtij institucioni. Të dhënat nxjerrin në pah edhe një perceptim të përbashkët të shqiptarëve për sa i përket inefektivitetit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit mbi punën e qeverisë dhe nevojën për forcimin e këtij roli. Propozimet për forcimin e rolit të opozitës duke i mundësuar kryesimin e të paktën 1/3 e komisioneve parlamentare dhe burime njerëzore shtesë morën mbështetje të moderuar (48.4%) nga të anketuarit. Nga ana tjetër, të anketuarit treguan mbështetje të madhe (81.9%) për propozimin që lidhet me forcimin e kompetencave të institucioneve të pavarura për sa i përket kontrollit të qeverisë. Për më tepër, nga anketimi kombëtar dhe nga diskutimet në grupe të vogla në aktivitetin “Shqipëria n’Kuvendim” u konstatua se në përgjithësi ka një nivel të ulët kuptimi për rolin mbikëqyrës të Kuvendit dhe zhvillimet politike në vend. Sa i përket rolit mbikëqyrës të Kuvendit, 35.7% e të anketuarve kishin pak njohuri, ndërsa vetëm 1.1% thanë se kishin shumë njohuri për të. Nga ana tjetër, 40.7% e të anketuarve kishin njohuri mesatare për atë që ndodhte në politikë dhe Parlament.



- 1 Anketimi deliberativ është një formë e veçantë e konsultimit politik ku ndërthuren teknikat e hulumtimit të opinionit publik dhe debatit publik për të zbuluar se çfarë opinionit do të kishte publiku për një çështje të caktuar nëse qytetarëve do t’u jepej një mundësi për t’u informuar më mirë. Anketimi deliberativ tenton të marrë parasysh preferencat dhe opinionet e qytetarëve para dhe pasi këta të fundit të kenë pasur mundësinë për të bërë gjykime të mirëvlerësuar bazuar në informacione të balancuara dhe pas diskutimeve me bashkëqytetarët e tjerë. Për më shumë informacion vizitoni <http://cdd.stanford.edu>
- 2 Në grupin eksperimental bënin pjesë qytetarë të zgjedhur rastësisht nga kampioni i anketimit kombëtar, të cilët patën mundësinë të diskutonin për temat në fjalë dhe të merrnin informacione nëpërmjet materialeve informuese dhe seancave me ekspertë të pavarur gjatë një aktiviteti katër-ditor të quajtur “Shqipëria n’Kuvendim”.
- 3 Në grupin e kontrollit bënin pjesë qytetarë të tjerë të zgjedhur rastësisht nga kampioni i anketimit kombëtar, por që nuk morën pjesë në aktivitetin katër-ditor.
- 4 Anketimi kombëtar u administrua nga IDM gjatë periudhës 8-18 tetor 2021.
- 5 Secila temë ishte objekt diskutimi për 60 minuta në tetë grupe të vogla debati dhe pasohej me një seancë diskutimi me ekspertë dhe pasohej me një të njëjtin minutazh.

HYRJE

Mbikëqyrja parlamentare është një funksion shumë i rëndësishëm për të bërë të mundur llogaridhënien dhe transparencën e qeverisë në veprimtarinë e saj. Nëse zbatohet me efektivitet, mbikëqyrja parlamentare mundëson balancën e pushteteve dhe është tregues i qeverisjes së mirë. Mbikëqyrja parlamentare është një nga aspektet më urgjente për përmirësimin e performancës së Kuvendit të Shqipërisë dhe forcimi i saj duhet të bëhet prioritet i punës së legjislaturës së re. Nga ana tjetër, mekanizmat e tjerë të kontrollit dhe balancës, të tilla si institucionet e pavarura⁶, funksionojnë, por kanë kompetenca të kufizuara dhe si rezultat, rekomandimet e tyre shpesh nuk zbatohen.⁷



6 Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Avokati i Popullit; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.


7 Shih Raporti për Shqipërinë i Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit të Komisionit Evropian, 19 tetor 2021, f. 15, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

PERCEPTIMET E SHQIPTARËVE PËR MBIKËQYRJEN PARLAMENTARE⁸

Në anketimin kombëtar dhe në grupet e vogla të diskutimit gjatë ushtrimit të anketimit deliberativ u shqyrtuan perceptimet dhe niveli i informacionit që kanë qytetarët për mbikëqyrjen parlamentare, për rolin e opozitës dhe institucioneve të pavarura si dhe për propozimet e tyre për forcimin e mbikëqyrjes. Gjetjet e këtij anketimi nxorën në pah nivelin e ulët të besimit të publikut të Kuvendi. Të pyetur se sa besojnë se Kuvendi në përgjithësi

bën atë që është e drejtë (gjënë e duhur), 40% e të anketuarve thanë se nuk e besojnë aspak këtë gjë, 29.2% kishin pak besim, ndërsa 22.3% deklaruan se besonin disi te Kuvendi. Më të prirur për të mos besuar aspak te Kuvendi ishin të anketuarit studentë dhe të papunë. Vetëm 6.7% e të anketuarve thanë se kishin shumë besim te Kuvendi, ndërkohë që 1.3% thanë se kishin jashtëzakonisht shumë besim, ndërsa 0.5% u përgjigjën "Nuk e di". *Shih Figurën 1.*

FIGURA 1. SA BESIM KENI SE PARLAMENTI NË PËRGJITHËSI BËN ATË QË ËSHTË E DREJTË (GJËNË E DUHUR)?



Pjesëmarrësit e aktivitetit "Shqipëria n'Kuvendim" vunë në pikëpyetje edhe integritetin e deputetëve si dhe evidentuan mungesën e transparencës së Kuvendit, gjë që mund të shpjegojë nivelin e ulët të besimit. Për


më tepër, një nga pjesëmarrësit u shpreh se ndjehej i papërfaqësuar "Deputetët i kemi të importuar, jo të zgjedhur, sepse listat zgjedhore janë të mbyllura," tha një nga pjesëmarrësit.

8 Në këtë seksion, në analizën e të dhënave për Figurën 6 deri Figura 9, shkalla nga 1-10 është grupuar në tre kategori: 0-3 e kundërshtoj, 4-6 neutral, dhe 7-10 e mbështes pohimin.

Për pyetjen se sa kuptojnë nga ajo që ndodh në politikë dhe Parlament, 40.7% thanë se e kuptonin disi (“mesatarisht”) atë që ndodhte në politikë dhe në Parlament. Pjesa tjetër e përgjigjeve ishte e ndarë mes kategorive ‘jashtëzakonisht shumë’ (4.4%); ‘shumë’ (20.2%);

‘pak’ (29.1%); ‘aspak’ (5.4%) dhe ‘Nuk e di’ (0.2%). *Shih Figurën 2.* Sipas karakteristikave demografike të të anketuarve, gratë dhe ata me nivel të ulët arsimor kishin më shumë gjasa të raportonin se nuk kuptonin nga ajo që ndodh në politikë dhe në Parlament.


FIGURA 2. SA KUPTONI JU PERSONALISHT NGA AJO QË NDODH NË POLITIKË DHE PARLAMENT?



Kur u pyetën se sa njohuri kishin për rolin kontrollues dhe mbikëqyrës të Parlamentit mbi qeverinë, vetëm 1.1% e të anketuarve u përgjigjën ‘jashtëzakonisht shumë’, 6.2% ‘shumë’ dhe 33% thanë se kishin njohuri mesatare në këtë drejtim. Shumica e të anketuarve (35.7%)

kishin njohuri të pakta dhe pjesa tjetër e tyre nuk kishin aspak njohuri (20.4%) ose nuk e dinin (3.6%). *Shih Figurën 3.* Të dhënat tregojnë për një nivel të kufizuar njohurish dhe informacioni mes të anketuarve për sa i përket një prej funksioneve kryesore të Kuvendit.


FIGURA 3. SA NJOHURI KENI PËR ROLIN KONTROLLUES DHE MBIKËQYRËS TË PARLAMENTIT MBI QEVERINË?



Shumica e të anketuarve (72.8%) ishin dakord për rëndësinë e kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare mbi qeverinë, ndërkohë që 19.2% priren të jenë neutralë (në mes), 5.4% e konsiderojnë atë si të parëndësishme dhe

2.6% thanë se nuk e dinin. *Shih Figurën 4.*⁹ Të anketuarit e me arsim të lartë prireshin më shumë ta konsideronin si të rëndësishëm funksionin mbikëqyrës të Parlamentit.

FIGURA 4. NË PARIM, SA TË RËNDËSISHËM E KONSIDERONI KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN E QEVERISË NGA PARLAMENTI?



Për sa i përket efektivitetit të kontrollit dhe mbikëqyrjes së Parlamentit mbi qeverinë, vetëm 18.6% e të anketuarve ishin në mbështetje të këtij pohimi, ndërsa 41.1% i konsideronin kontrollin dhe mbikëqyrjen joefektive, 35.1% prireshin të ishin neutralë dhe 5.2% thanë se nuk e dinin. *Shih Figurën 5.*¹⁰ Kjo sugjeron që pavarësisht se rëndësia e mbikëqyrjes parlamentare pranohet gjerësisht, siç tregohet në Figurën 4, shumë pak njerëz e konsiderojnë këtë mbikëqyrje si efektive në realitet.

Rezultatet e anketimit kombëtar tregojnë se shumica e të anketuarve (48.4%) e mbështesnin propozimin për t'i mundësuar opozitës

të kryesonte të paktën 1/3 e komisioneve parlamentare, ndërsa 32.1% prireshin të ishin neutralë, ndërkohë që 13.7% ishin kundër dhe 5.8% thanë se nuk e dinin. *Shih Figurën 6.*

Gjatë diskutimeve në grupe të vogla në aktivitetin "Shqipëria n'Kuvendim", pjesëmarrësit ishin të ndarë për sa i përket këtij propozimi. Në njërën anë, disa pjesëmarrës argumentonin se forcimi i rolit të opozitës do të rriste llogaridhënien e qeverisë. Nga ana tjetër, disa pjesëmarrës të tjerë thanë se përbërja e parlamentit duhet të përfaqësojë vullnetin e votuesve dhe se një masë e tillë do të ndërhynte te ky i fundit.



- 9 Në analizë, shkalla nga 1-10 është grupuar në tre kategori: 0-3 të parëndësishëm, 4-6 neutral, dhe 7-10 të rëndësishëm.
- 10 Në analizë, shkalla nga 1-10 është grupuar në tre kategori: 0-3 jo efektiv, 4-6 neutral, dhe 7-10 efektiv.

FIGURA 5. NË SHQIPËRI SA EFEKTIV ËSHTË KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E QEVERISË NGA PARLAMENTI?





FIGURA 6. T'I MUNDËSOHET OPOZITËS QË TË KRYESOJË TË PAKTËN 1/3 E KOMISIONEVE PARLAMENTARE.




Kur të anketuarve iu kërkua të jepnin vlerësimin e tyre për propozimin për t'i dhënë opozitës më shumë burime njerëzore për të ushtruar kontroll dhe mbikëqyrje ndaj qeverisë, 46.2% ishin dakord me këtë propozim, 33.3% ishin neutralë, 17.9% u shprehën kundër këtij propozimi dhe 2.6% thanë se nuk e dinin. *Shih Figurën 7.*

Gjatë diskutimeve në grupe të vogla në aktivitetin "Shqipëria n'Kuvendim", disa nga pjesëmarrësit ishin skeptikë ndaj kësaj ideje me argumentin se ofrimi i më shumë burimeve njerëzore për opozitën nuk garanton domosdoshmërisht cilësi apo efektivitet dhe mund të jetë me kosto të mëdha. Në kahun tjetër, disa pjesëmarrës të tjerë sugjeruan se mund të ishte më e realizueshme rritja

e kapaciteteve ekzistuese sesa garantimi i burimeve njerëzore shtesë. Gjithsesi, në përgjithësi, pjesëmarrësit pranuan nevojën e fuqizimit të opozitës si dhe të aktorëve të tjerë jopolitikë që luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimtarisë së qeverisë, të tilla si media dhe organizatat e shoqërisë civile.

Anketimi konstaton se shumica dërrmuese e të anketuarve (70.1%) janë në mbështetje të propozimit për zgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të pavarura me shumicë të cilësuar votash në Kuvend. Meshkujt dhe të anketuarit e punësuar në sektorin publik prireshin më shumë ta mbështesnin këtë pohim. Nga ana tjetër, 20.8% e të anketuarve ishin neutralë, 5% ishin kundër një propozimi të tillë dhe 4.1% thanë se nuk e dinin. *Shih Figurën 8.*


FIGURA 7. T'I MUNDËSOHEN OPOZITËS MË SHUMË BURIME NJERËZORE PËR TË USHTRUAR KONTROLLIN DHE MBIKËQYRJEN E QEVERISË.



Pjesëmarrësit në aktivitetin “Shqipëria n’Kuvendim” ishin në përgjithësi dakord se kërkesa për një shumicë të cilësuar do të ofronte më shumë garanci për pavarësinë e këtyre institucioneve. Megjithatë, disa pjesëmarrës theksuan se ekziston rreziku që

partia në pushtet dhe opozita të dështonin në arritjen e konsensusit, duke prodhuar kështu krizë politike, siç ka ndodhur në të kaluarën e afërt.

FIGURA 8. KRERËT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA TË ZGJIDHEN ME SHUMICË TË CILËSUAR (2/3) E VOTAVE NË PARLAMENT.




Për më tepër, 81.9% e të anketuarve shprehën shumë mbështetje për propozimin për rritjen dhe forcimin e kompetencave të institucioneve të pavarura (Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit, etj.) për të kontrolluar qeverinë, përfshirë këtu edhe masa ndëshkuese. Të anketuarit e punësuar në sektorin publik ishin më shumë pro këtij propozimi. Nga ana tjetër, 13.4% e të anketuarve ishin neutralë, 2,7% nuk

e mbështetën këtë pohim dhe 2% thanë se nuk e dinin. *Shih Figurën 9.*

Pjesëmarrësit në aktivitetin “Shqipëria n’Kuvendim” pranuan nevojën për forcimin e këtyre institucioneve për të trajtuar disbalancën aktuale të pushtetit.

FIGURA 9.TË RRITEN DHE FORCOHEN KOMPETENCAT E INSTITUCIONEVE TË PAVARURA (P.SH. KLSH, AVOKATI I POPULLIT ETJ.) NË KONTROLLIN NDAJ QEVERISË, PËRFSHIRË EDHE KOMPETENCA NDËSHKUESE (P.SH GJOBA).



METODOLOGJIA

Për anketimin kombëtar u përdor një kampion përfaqësues i popullsisë shqiptare, ku të anketuarit u zgjodhën në mënyrë rastësore nga të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative të vendit. Përdorimi i një kampioni të ponderuar përfaqësimit kombëtar na bën të mundur që gjetjet t'i aplikojmë për të gjithë popullsinë në vend. Si rrjedhim, niveli i rëndësisë statistikore të kampionit përshkruhet si vijon: për një popullatë shqiptare rezidente në moshë madhore prej 2,220,569 , me një madhësi kampioni prej 1,200 të anketuarve, për një nivel besimi 95%, intervali i besimit është $\pm 2,83$; dhe për një nivel besimi prej 99%, intervali i besimit është $\pm 3,72$.


Për të përcaktuar madhësinë e kuotës së secilit prej qarqeve të vendit, numri i popullsisë së Shqipërisë u mor nga regjistri civil, ndërsa numri i banorëve për secilin qark në 1 janar 2021 u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Edhe pse se numri i banorëve në moshën mbi 18 vjeç ndryshonte me vetëm 0,31% mes viteve 2019 dhe 2021, ky ndryshim nuk ndikoi statistikisht në madhësinë e kampionit sipas qarkut dhe në intervalin e besimit të përmendur më sipër. Kampioni prej 1,200 të anketuarish u shpërnda në të 61 bashkitë e 12 qarqeve të vendit. Më pas, shpërndarja sipas qarkut u përshtat për të zgjedhur vetëm popullsinë në moshë madhore (mbi 18 vjeç) dhe për të përdorur kontrolle kuotash për gjininë. Duke qenë se INSTAT nuk i përcakton grupmoshat nën 18 vjeç ose mbi 18 vjeç, është përdorur teknika e interpolimit linear. Më pas, kjo përzgjedhje u ponderua sipas grupmoshave më të fundit të publikuara nga INSTAT (në kohën kur u hodh shorti), që ishin të dhënat për vitin 2020. Rezultatet e përlogaritura dhe të publikuara në këtë analizë janë ponderuar sipas dy dimensioneve: shpërndarja gjeografike e popullsisë dhe grupmosha.

DEMOGRAFIA E TË ANKETUARVE


Në total morën pjesë në anketimin kombëtar 1,200 qytetarë shqiptarë të moshës 18 vjeç e sipër nga të gjitha bashkitë e Republikës së Shqipërisë. Nga ky kampion me përfaqësim kombëtar, 55.1% ishin meshkuj dhe 44.9% ishin femra. Pjesa më e madhe e të anketuarve i përkiste grupmoshave që varionin nga 18 vjeç

në 54 vjeç (63.9%). Të anketuarit e moshës 55 vjeç dhe më shumë përbënin vetëm 36.1% të të gjithë kampionit përfaqësues. Lutemi referojuni grafikëve të mëposhtëm për më shumë hollësi në lidhje me shpërndarjen sipas moshës së kampionit.

MOSHA




GJINIA



Shpërndarja gjeografike ishte 68.6% urbane dhe 31.4% rurale. Si për krahasim, të dhënat e Institutit të Statistikave (INSTAT) thonë se në vitin 2011, 58.2% e popullsisë rezidente

shqiptare banonte në zonat urbane.¹¹ Megjithatë, gjatë dhjetë viteve të fundit, ky numër është rritur.


VENDBANIMI



Pjesa më e madhe e të anketuarve (70.8%) kishin një diplomë të shkollës së mesme ose kishin diplomë universitare apo pasuniversitare, ku 43.1% e tyre kishin përfunduar arsimin e mesëm (d.m.th., kishin diplomë të shkollës së mesme), ndërsa 27.7% kishin marrë diplomë

universitare ose pasuniversitare. Plot 28.2% e të anketuarve kishin arsim të mesëm të ulët, ku 19.6% e të anketuarve kishin përfunduar programin e detyrueshëm 8/9-vjeçar, ndërsa 8.6% nuk kishin përfunduar asnjë nivel arsimor ose kishin vetëm arsim fillor (4/5 klasë shkollë).

NIVELI ARSIMOR




11 http://www.instat.gov.al/media/2919/a_new_urban-rural_classification_of_albanian_population.pdf


Rreth 46.9% e të anketuarve ishin të punësuar në kohën e anketimit, teksa 72.4% e tyre punonin në sektorin privat dhe 27.6% ishin të punësuar në sektorin publik. Rreth një e

pesta e të anketuarve deklaruan se ishin të papunë (19.3%), ndërsa 6% ishin studentë, 20.9% në pension dhe 5.4% zgjedhën përgjigjen alternative "tjetër".

STATUSI I PUNËSIMIT




SEKTORI I PUNËSIMIT



Për sa i përket nivelit të të ardhurave të rregullta mujore individuale të të anketuarve, 22.5% e të tyre deklaruan se nuk kishin të ardhura të rregullta në kohën e anketimit, 33,2% fitonin deri në 30,000 lekë/muaj, ndërsa

21,2% raportuan se merrnin të ardhura të rregullta mujore që varionin nga 30,001 lekë në 50,000 lekë. Vetëm 14.2% e të anketuarve thanë se kishin të ardhura mujore individuale mbi 50 mijë lekë.

NIVELI I TË ARDHURAVE TË RREGULLTA MUJORE INDIVIDUALE (NETO)



Tiranë, Shkurt 2022

© 2022 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1

1017 Tirana, Albania

E-mail: info@idmalbania.org

Website: www.idmalbania.org

SHËNIM

Ky raport tematik u përgatit nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Autorësia e këtij botimi i përket vetëm IDM-së. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo lloj forme ose me çfarëdo lloj mjeti pa lejen paraprake me shkrim të IDM-së.



NJË PROJEKT NGA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

ZBATUAR NGA



PARTNERË NË ZBATIM



"Mbështetje për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri" (PACEP), është një projekt nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI)."

Ky aktivitet u zhvillua nga IDM në kuadër të projektit PACEP, në konsultim me Qendrën për Demokraci Deliberative pranë Universitetit të Stanford (ShBA).